

20261562285

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 9, paragrafi (1) të Ligjit për Prodhim Bujqësor Organik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 146/09, 53/11, 149/15, 39/16, 132/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 150/21) dhe nenit 35 të Ligjit për Ekzekutimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 253/25), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 7 korrik 2026, miratoi:

PROGRAM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE NË PRODHIMIN BUJQËSOR ORGANIK PËR VITIN 2026

I

Mjetet për mbështetje financiare në prodhimin bujqësor organik për vitin 2026, në shumën e përgjithshme prej 100.000.000,00 denarë, të siguruar në përputhje me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 253/25), Ndarja 14004 – Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (në tekstin vijues: Agjencia), Nënprogrami 24, zëri 464 – Transfere të ndryshme, do të shfrytëzohen sipas masave në vijim, për:

Numri i masës	Emri i masës	Shuma e përgjithshme e masës në denarë
1.	Mbështetje financiare për prodhimin bujqësor organik (prodhim bimor dhe blegtoral)	6.000.000,00
2.	Mbështetje financiare për përpunimin e produkteve organike dhe produkteve organike në periudhën e konvertimit me origjinë vendase (përfshirë përpunimin përfundimtar dhe paketimin e llojeve të egra me origjinë organike)	1.000.000,00
3.	Mbështetje financiare për tregtinë ose marketingun e produkteve të freskëta dhe të përpunuara organike, si dhe produkteve organike në periudhën e konvertimit me origjinë vendase	1.500.000,00
4.	Mbështetje financiare për pagesa të veçanta direkte për kontrollin profesional dhe certifikimin	500.000,00
5.	Mbështetje financiare për pagesa të veçanta direkte për analizën e produkteve në ekonomitë bujqësore	1.000.000,00

6.	Detyrime të papaguara nga Programet për mbështetje financiare në prodhimin bujqësor organik për vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025	90.000.000,00
	Gjithësej	100.000.000,00

II

(1) Mjetet nga pjesa I, masa 1 e këtij Programi, të dedikuara për mbështetje financiare për prodhimin bujqësor organik (prodhim bimor dhe blegtoral), në shumën e përgjithshme prej 6.000.000,00 denarë, do të shfrytëzohen për realizimin e nënmasave në vijim, në përputhje me kriteret më të përafërta të përcaktuara në Rregulloren për kriteret më të përafërta për pagesat direkte, përfituesit e mjeteve, shumat maksimale dhe mënyrën e realizimit të pagesave direkte për vitin 2026 (në tekstin vijues: Rregullorja):

Numri i nënmasës	Emri i nënmasës
1.1.	Pagesa direkte për sipërfaqe bujqësore të përpunueshme për kultura arash, organike dhe në periudhën e konvertimit
1.2	Pagesa direkte për sipërfaqe bujqësore të përpunueshme për vreshta dhe plantacione frutore, organike dhe në periudhën e konvertimit
1.3.	Pagesa direkte për sipërfaqe bujqësore të përpunueshme për kultura perimore në fushë të hapur dhe në sera, organike dhe në periudhën e konvertimit
1.4.	Pagesa direkte për sipërfaqe bujqësore të përpunueshme për kultura perimore në kushte të kontrolluara, organike dhe në periudhën e konvertimit
1.5.	Pagesa direkte për krerët e shënuar femra të gjedhit në moshë nga 18 deri në 180 muaj, për të gjitha kategoritë organike dhe në periudhën e konvertimit
1.6.	Pagesa direkte për krerët e shënuar femra të gjedhit në moshë nga 6 deri në 18 muaj, për të gjitha kategoritë organike dhe në periudhën e konvertimit
1.7.	Pagesa direkte për krerët e shënuar të deleve më të vjetra se 12 muaj, për të gjitha kategoritë organike dhe në periudhën e konvertimit
1.8.	Pagesa direkte për krerët e shënuar të dhive më të vjetra se 12 muaj, për të gjitha kategoritë organike dhe në periudhën e konvertimit
1.9.	Pagesa direkte për familje bletësh të regjistruara dhe të dimëruara, për të gjitha kategoritë organike dhe në periudhën e konvertimit

(2) Përfitues të mjeteve nga nënmasa 1.1 e kësaj pjese janë ekonomitë bujqësore të cilat janë përfituese të mjeteve nga nënmasa 1.1 e Rregullores.

Lartësia e pagesave direkte rritet për 3.000,00 denarë për hektar në raport me shumën e përcaktuar për pagesat direkte nga nënmasa 1.1, pika 5 e Rregullores, me përjashtim të duhanit,

për 6.500,00 denarë për hektar për nënmasën 1.1, pika 6 të Rregullores dhe për 5.250,00 denarë për hektar për nënmasën 1.1, pika 7 të Rregullores.

Lartësia e mbështetjes nga kjo nënmasë zvogëlohet me rritjen e sipërfaqeve të deklaruar, si vijon: deri në 50 ha paguhet 100%, nga 50 ha deri në 100 ha paguhet 60%, ndërsa mbi 100 ha paguhet 30%, në mënyrë të përmblendhur për të gjitha kulturat.

(3) Përfitues të mjeteve nga nënmasa 1.2 e kësaj pjese janë ekonomitë bujqësore të cilat janë përfituese të mjeteve nga nënmasa 1.2 e Rregullores.

Lartësia e pagesave direkte rritet për 29.400,00 denarë për hektar në raport me shumën e përcaktuar për pagesat direkte nga nënmasa 1.2, pika 3 e Rregullores, për 25.900,00 denarë për hektar për nënmasën 1.2, pika 4, për 23.800,00 denarë për hektar për nënmasën 1.2, pika 5, për 17.500,00 denarë për hektar për nënmasat 1.2, pikat 6 dhe 7, si dhe për 8.400,00 denarë për hektar për nënmasën 1.2, pika 8 të Rregullores.

Lartësia e mbështetjes nga kjo nënmasë për kulturat frutore zvogëlohet me rritjen e sipërfaqeve të deklaruar, si vijon: deri në 5 ha paguhet 100%, nga 5,1 ha deri në 30 ha paguhet 60%, ndërsa mbi 30 ha paguhet 30%.

Lartësia e mbështetjes për vreshtat nga kjo nënmasë zvogëlohet me rritjen e sipërfaqeve të deklaruar, si vijon: deri në 10 ha paguhet 100%, nga 10 ha deri në 30 ha paguhet 60%, ndërsa mbi 30 ha paguhet 30%.

(4) Përfitues të mjeteve nga nënmasa 1.3 e kësaj pjese janë ekonomitë bujqësore të cilat janë përfituese të nënmasës 1.3 të Rregullores.

Lartësia e pagesave direkte rritet për 30.000,00 denarë për hektar në raport me shumën e përcaktuar për pagesat direkte nga nënmasa 1.3, pika 3 e Rregullores dhe për 12.000,00 denarë për hektar për nënmasën 1.3, pika 4 të Rregullores.

Lartësia e mbështetjes nga kjo nënmasë zvogëlohet me rritjen e sipërfaqeve të deklaruar, si vijon: nga 0,3 ha deri në 10 ha paguhet 100%, nga 10 ha deri në 50 ha paguhet 60%, nga 50 ha deri në 100 ha paguhet 30%, ndërsa mbi 100 ha paguhet 10%, në mënyrë të përmblendhur për të gjitha kulturat perimore.

(5) Përfitues të mjeteve nga nënmasa 1.4 e kësaj pjese janë ekonomitë bujqësore të cilat janë përfituese të nënmasës 1.4 të Rregullores.

Lartësia e pagesave direkte rritet për 84.000,00 denarë për hektar në raport me shumën e përcaktuar për pagesat direkte nga nënmasa 1.4, pika 1 e Rregullores.

(6) Përfitues të mjeteve nga nënmasa 1.5 e kësaj pjese janë ekonomitë bujqësore të cilat janë përfituese të nënmasës 1.7 të Rregullores.

Lartësia e pagesave direkte rritet për 4.000,00 denarë për krerë femër të shënuar të gjedhit, në moshë nga 18 deri në 180 muaj, për të gjitha kategoritë organike dhe në periudhën e konvertimit, në raport me shumën e përcaktuar për pagesat direkte nga nënmasa 1.7, pika 4 e Rregullores.

Lartësia e mbështetjes nga kjo nënmasë zvogëlohet me rritjen e numrit të krerëve të shënuar dhe llogaritet në mënyrë shkallëzuese, si vijon: nga 3 deri në 100 krerë paguhet 100%, nga 101 deri në 150 krerë paguhet 70%, nga 151 deri në 300 krerë paguhet 40%, ndërsa mbi 301 krerë paguhet 20%.

(7) Përfitues të mjeteve nga nënmasa 1.6 e kësaj pjese janë ekonomitë bujqësore të cilat janë përfituese të nënmasës 1.8 të Rregullores.

Lartësia e pagesave direkte rritet për 1.500,00 denarë për krerë femër të shënuar të gjedhit, në moshë nga 6 deri në 18 muaj, për të gjitha kategoritë organike dhe në periudhën e konvertimit, në raport me shumën e përcaktuar për pagesat direkte nga nënmasa 1.8, pika 2 e Rregullores.

(8) Përfitues të mjeteve nga nënmasa 1.7 e kësaj pjese janë ekonomitë bujqësore të cilat janë përfituese të nënmasës 1.9 të Rregullores.

Lartësia e pagesave direkte rritet për 1.500,00 denarë për krerë dele të shënuar, më të vjetra se 12 muaj, për të gjitha kategoritë organike dhe në periudhën e konvertimit, në raport me shumën e përcaktuar për pagesat direkte nga nënmasa 1.9, pika 4 e Rregullores.

(9) Përfitues të mjeteve nga nënmasa 1.8 e kësaj pjese janë ekonomitë bujqësore të cilat janë përfituese të nënmasës 1.10 të Rregullores.

Lartësia e pagesave direkte rritet për 1.500,00 denarë për krerë dhi të shënuar, më të vjetra se 12 muaj, për të gjitha kategoritë organike dhe në periudhën e konvertimit, në raport me shumën e përcaktuar për pagesat direkte nga nënmasa 1.10, pika 2 e Rregullores.

(10) Përfitues të mjeteve nga nënmasa 1.9 e kësaj pjese janë ekonomitë bujqësore të cilat janë përfituese të nënmasës 1.12 të Rregullores.

Lartësia e pagesave direkte rritet për 300,00 denarë për familje bletësh të dimëruara, për të gjitha kategoritë organike dhe në periudhën e konvertimit, në raport me shumën e përcaktuar për pagesat direkte nga nënmasa 1.12, pika 2 e Rregullores, si dhe për 100,00 denarë për më shumë se 50 familje bletësh të dimëruara sipas nënmasës 1.12, pika 3 të Rregullores.

III

(1) Mjetet nga pjesa I, masa 2 e këtij Programi, të dedikuara për mbështetje financiare për përpunimin e produkteve organike dhe produkteve organike në periudhën e konvertimit me

originë vendase (përfshirë përpunimin përfundimtar dhe paketimin e llojeve të egra me originë organike), do të shfrytëzohen për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në këtë Program.

(2) Përfitues të masës 2 nga pjesa I e këtij Programi janë ekonomitë bujqësore dhe/ose grumbulluesit e regjistruar në Regjistrin e grumbulluesve të produkteve bujqësore, të cilët kanë prodhuar produkte të përpunuara nga produkte primare bujqësore organike ose produkte në periudhën e konvertimit me originë vendase, ose kanë realizuar përpunimin përfundimtar dhe paketimin e llojeve të egra me originë organike, dhe të njëjtat i kanë shitur.

(3) Përfitues të masës 2 nga pjesa I e këtij Programi janë gjithashtu ekonomitë bujqësore – prodhues të qumështit organik të lopës, deles dhe dhisë, të regjistruara si mbarështues të gjedhëve, deleve dhe dhive, si dhe prodhues të djathit të përfituar nga qumështi organik i deleve dhe dhive / baxhove.

(4) Lartësia e pagesave direkte për masën 2 nga pjesa I e këtij Programi është 10% e vlerës së produkteve të prodhuara dhe të shitura, por jo më shumë se 150.000,00 denarë për operator dhe 30.000,00 denarë për produkt organik të certifikuar ose produkt organik në periudhën e konvertimit me originë vendase, për jo më shumë se pesë produkte organike të përpunuara të certifikuara.

IV

(1) Mjetet nga pjesa I, masa 3 e këtij Programi janë të dedikuara për mbështetje financiare për tregtinë ose marketingun e produkteve të freskëta dhe të përpunuara organike, si dhe produkteve organike në periudhën e konvertimit me originë vendase.

(2) Përfitues të masës 3 nga pjesa I e këtij Programi janë ekonomitë bujqësore dhe/ose grumbulluesit e regjistruar në Regjistrin e grumbulluesve të produkteve bujqësore, të cilët kryejnë tregti ose marketing të produkteve të freskëta dhe të përpunuara organike, si dhe produkteve organike në periudhën e konvertimit me originë vendase.

(3) Lartësia e pagesave direkte për masën 3 nga pjesa I e këtij Programi është 5% e vlerës së produkteve të shitura, por jo më shumë se 150.000,00 denarë për operator.

V

(1) Mjetet nga pjesa I, masa 4 e këtij Programi janë të dedikuara për mbështetje financiare për pagesa të veçanta direkte për kontrollin profesional dhe certifikimin.

(2) Përfitues të masës 4 nga pjesa I e këtij Programi janë ekonomitë bujqësore dhe/ose grumbulluesit e regjistruar në Regjistrin e grumbulluesve të produkteve bujqësore nga fusha e prodhimit bujqësor organik, të cilët kanë marrë certifikatë nga një trup i autorizuar gjatë vitit 2026.

(3) Lartësia e pagesave direkte për masën 4 nga pjesa I e këtij Programi është 50% e shpenzimeve për certifikatën e marrë, të lëshuar nga një trup i autorizuar gjatë vitit 2026.

VI

(1) Mjetet nga pjesa I, masa 5 e këtij Programi janë të dedikuara për mbështetje financiare për pagesa të veçanta direkte për analizën e produkteve në ekonomitë bujqësore.

(2) Përfitues të masës 5 nga pjesa I e këtij Programi janë ekonomitë bujqësore dhe/ose grumbulluesit e regjistruar në Regjistrin e grumbulluesve të produkteve bujqësore, të cilët kanë kryer analiza për mbetjet e pesticideve, metalet e rënda dhe substanca të tjera në produktet organike gjatë vitit 2026.

(3) Lartësia e pagesave direkte për masën 5 nga pjesa I e këtij Programi është 80% e shpenzimeve për analizën, pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar, por jo më shumë se 12.000,00 denarë për ekonomi bujqësore dhe/ose grumbullues.

VII

(1) Përfitues të pagesave direkte për nënmasat nga pjesa I, masa 1 e këtij Programi janë ekonomitë bujqësore të cilat kanë prodhim organik bimor dhe/ose blegtoral të certifikuar dhe/ose prodhim në periudhën e konvertimit, në përputhje me Ligjin për Prodhim Bujqësor Organik.

(2) Pagesat direkte nga pjesa I, masat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij Programi do të realizohen përmes paraqitjes së kërkesës për mbështetje financiare pranë Agjencisë, në përputhje me Rregulloren.

VIII

Mjetet nga pjesa I, masa 6 e këtij Programi janë të dedikuara për pagesën e detyrimeve të mbetura nga Programet për mbështetje financiare në prodhimin bujqësor organik për vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025.

IX

(1) Afati përfundimtar për paraqitjen e kërkesave për pagesa direkte në prodhimin bujqësor organik për vitin 2026, për masën 1 nga pjesa I e këtij Programi, përkatësisht për nënmasat nga pjesa II e këtij Programi, është përcaktuar në Rregullore.

(2) Afati përfundimtar për paraqitjen e kërkesave për pagesa direkte në prodhimin bujqësor organik për vitin 2026, për masat 2, 3, 4 dhe 5 nga pjesa I e këtij Programi, është 25 dhjetor 2026.

X

Pagesën e mjeteve nga ky Program, sipas përfituesve, e realizon Agjencia.

XI

Ky Program hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Nr. 57-4434/10
7 Korrik 2026
Shkup

Kryetari i Qeverisë
së Republikës së Maqedonisë së Veriut
prof.dr. **Hristijan Mickoski**, n.p